



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:035125
Datë: 22.10.2024
Numri i dokumentit: 06330826

PPP.nr.184/24

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, Gjyqtarja Blerina KURTAJ, në çështjen juridike përmbartimore të kreditores G. B. nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqësojnë Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj, avokat me seli në Prishtinë, kundër debitorit Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, me seli në Gjakovë, përfaqësuar sipas autorizimit nga e autorizuar Qendresa Bytyqi Hoxha, sipas dokumentit përmbartimor për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e Përmbartimit numër P.nr.1223/24 të datës 10.07.2024, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi , me seli në Gjakovë, jashtë seancës, me datë 22.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET si i pa bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, me seli në Gjakovë, i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e Përmbartimit numër P.nr.1223/24 të datës 10.07.2024, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi , me seli në Gjakovë.
- II. Mbetet në fuqi Urdhri për lejimin e Përmbartimit numër P.nr.1223/24 të datës 10.07.2024, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi , me seli në Gjakovë.
- III. Obligohet debitori, që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim të ja paguaj kreditorit shumën prej 156,00 euro, në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të këtij Aktvendimi, nën kërcënim të përmbartimit.

A r s y e t i m

Përmbauesi Privat Gjakë Radi , me seli në Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit G. B., nga Gjakova, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj, avokat me seli në Prishtinë, ka lëshuar urdhër me numër P.nr.1223/24 të datës 10.07.2024 me të cilin ka lejuar përmbauesin në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, me numër C.nr.3292/23 i datës 21.05.2024 i plotfuqishëm me datë 19.06.2024 dhe i ekzekutueshëm nga data 28.06.2024. Me propozimin për përmbauesin ka kërkuar që të caktohet përmbauesi ashtu që të detyrohet debitori Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, me seli në Gjakovë, që kreditorit t'ia paguaj borxhin kryesor shumën prej 1.718,20€, shumën prej 124.00€, në emër të shpenzimeve procedurale, si dhe shumën prej 156.00€ në emër të shpenzimeve përmbauesore.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbauesimit, brenda afatit ligjor, prapësim ka paraqitur debitori, duke e kundërshtuar në tërësi propozimin për përmbauesin si dhe urdhrin për përmbauesin si të pa bazuar. Dhe i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin për përmbauesin të shfuqizoj, gjegjësisht ta hedhë poshtë si të pabazuar.

Kreditori, përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur përgjigje në prapësim duke i propozuar gjykatës që ta refuzoi si të pa bazuar prapësimin e debitorit dhe ta aprovoj si të bazuar Urdhrin Përmbauesor të lëshuar nga Përmbauesi Privat, dhe ta detyron debitorin që të i paguaj shpenzimet në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim, në shumë prej 156,00 €. Me arsyetim se konsiderojnë se prapësimi i debitorit ka mungesë të provave dhe fakteve dhe nuk është i bazuar në asnjë nga shkaqet e prapësimit të parapara me nenin 71 të LPP-së. Urdhri Përmbauesor i lejuar është konform nenit 22 të LPP-së, përkatësisht në bazë në Vendimit Gjyqësor i cili është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe ato të kreditorit në përgjigjen në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi nuk është i bazuar, nga këto arsye:

Gjykata ka vlerësuar se përmbauesimi i lejuar nga ana e Përmbauesit Privat bazohet në dokumentin përmbauesor - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm,

me numër C.nr.3292/23 i datës 21.05.2024 i plotfuqishëm me datë 19.06.2024 dhe i ekzekutueshëm nga data 28.06.2024 në bazë të cilit organi përmbarues edhe e ka zbatuar përmbarimin. Me dispozitën e nenit 21 të LPP-së parashihet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Pra, në rastin konkret aktgjykimi ka shërbyer si bazë për lejimin e përmbarimit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës, Aktgjykimi në fjalë është dokument përmbarues, i ekzekutueshëm dhe përbën bazë të ligjshme juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i njëjti i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 22 paragrafin 1, nën par.1.1. të LPP-së ku parashihet në paragrafin 1 *“Dokumentet përmbaruese janë: 1.1. vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësor përmbarues;”* lidhur me nenin 24 paragrafi 1 të LPP-së, ku citohet *“vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarueshëm po që se ka marrë formën e prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushjen vullnetare”* si dhe njëkohësisht është edhe i përshtatshëm për përmbarim në kuptim të nenit 27 par.1 të LPP-së, ku thuhet se *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Pretendimet e debitorit lidhur me ligjshmërinë e dokumentit përmbarimor gjykata i mori si jo relevante në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit rigoroz formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e lartcekura.

Gjykata analizoi pretendimet e paraqitura nga debitorit, mirëpo arsyet e dhëna në prapësim, ishin të pa bazuara, njëkohësisht kishin të bënin me çështje që paraqitën si bazë ankimore kundër vendimit meritor në procedurë kontestimore.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenin 13 dhe 17 të LPP-së lidhur me nenin 452 dhe 463, par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, duke obliguar debitorin që kreditorit në emër të shpenzimeve për përpilim të përgjigjes në prapësim të ia paguaj shumën prej 156.00 €, ashtu siç e parasheh Tarifa e Odës së Avokatëve.

Andaj, nga arsyet e paraqitura, gjykata vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit e të cilat janë paraparë në nenin 71 të LPP-së. Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitivit të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
PPP.nr.184/24, me datën 22.10.2024

Gjyqtarja,
Blerina KURTAJ

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.